

**VENDIM**  
**Nr. 463, datë 30.5.2013**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË,  
USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT TE MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE  
DHE TRANSPORTIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, TË ISH-KOMPLEKSIT TË  
STALLAVE TË ISH-FERMËS BUJQËSORE KAMËZ, TË NDODHUR NË ZONËN  
KADASTRALE NR. 2066 TË BASHKISË KAMËZ, PËR QËLLIM PRIVATIZIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit te Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, të objektit ish-kompleksi i stallave të ish-Fermës Bujqësore Kamëz, të ndodhur në zonën kadastrale nr. 2066, në Kamëz dhe të truallit nën objekte, sipas planvendosjes së objekteve bashkëlidhur, me qëllim privatizimin në favor të banorëve që banojnë në këto godina, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave që, pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, të bëjë privatizimin e tyre, për familjet e personave të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, sipas procedurave që përcaktohen me udhëzimin nr. 17, datë 17.10.2012 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për procedurat e shitjes së banesave pjesë përbërëse e objekteve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi”.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**